



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:178270

Datë: 20.11.2024

Numri i dokumentit: 06482682

PKR.nr.124/24

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, Kryetari i Trupit Gjykses Alban Ajvazi, me Anëtarët e Trupit Gjykses Gent Beka dhe Naser Foniqi, si dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leutrim Hoti, në çështjen penale ndaj të pandehurve: A.B.1 dhe A.B.2 për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Vrasje në tentative nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe me nenin 31 dhe veprës penale në bashkëkryerje Asgjësim apo dëmtim i pasurisë, nga neni 321 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i pandehuri A.B.1 edhe për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, PP/I.Nr.74/2024, të datës 24.06.2024, pas mbajtjes së seancës dëgjimore të datës 04.11.2024 për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në të cilën kanë marrë pjesë Prokurori i Shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, si dhe i dëmtuari A.O me përfaqësuesin e tij av. Jeton Maqedonci, në të njëjtën datë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë 20.11.2024 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I. A.B.1, nga i ati S.1 dhe e ëma S.2 e gjinisë A., i lindur me datën ..., në ..., me vendbanim në Fshatin ..., Komuna Fushë Kosovë, dhe adresa e dytë, Lagjja ..., Prishtinë, ..., i martuar, ka të

kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. A.B.2, nga i ati M. dhe e ëma Sh. e gjinisë R., i lindur me datë ..., në Mitrovicë, me vendbanim në Fushë Kosovë, Rruga "...", ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, student, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## I

### JANË FAJTORË

Sepse:

Të akuzuarit A.B.1 dhe A.B.2 janë fajtor për shkak se me datë 11.04.2024, rreth orës 01:30 minuta, në rrugën "... " në Lagjen ..., Prishtinë, për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme në mes të të pandehurit A.B.2 me të dëmtuarin A.O për çka edhe janë iniciuar tjera procedura penale, të pandehurit A.B.2 dhe A.B.1 në bashkëkryerje, me dashje direkte tentojnë të privojnë nga jeta të dëmtuarin, në atë mënyrë që fillimisht, të pandehurit me veturën e tipit Golf 5, me targa të regjistrimit ... pronë e dëshmitarit B.H, të cilën e drejtonte i pandehuri A.B.2 dhe pasagjerë i pandehuri A.B.1, e përcjellin nga mbrapa automjetin e të dëmtuarit të tipit Mercedes GLE, që nga hyrja Jugore në lagjen ..., dhe posa i dëmtuari del nga vetura pasi e ka parkuar para shtëpisë së prindërve të tij, në atë moment me shpejtësi ofrohet vetura e tipit Golf 5, dhe nga ana e pasagjerit, në ulësen mbrapa i pandehuri A.B.1 e nxjerrë dorën jashtë dritares duke shkrepur me armë zjarri gjashtë (6) herë në drejtim të të dëmtuarit i cili fshihet pas veturës së tij, dhe më pas të njëjtit kanë ikur me veturë nga vendi i ngjarjes;

Me këtë kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje Vrasja në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së.

## II

I akuzuari A.B.1 është fajtor për shkak se me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e parë, i pandehuri A.B.1, ka mbajtur armën në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar në shkelje me ligjin e zbatueshëm për armët me nr. 05/L-022, në atë mënyrë që, në vendin e ngjarjes ka

shkrepur me armë zjarri pistolete, në drejtimin e të dëmtuarit A.O e të cilën armë e ka fshehur dhe gjatë kontrollit në trotuar është gjetur një predhë e dëmtuar e fishekut të kalibrit të panjohur dhe një gëzhjë e kalibrit 9mm PPU Luger, e të cilat janë sekuestruar nga policia me ç'rast, sipas raportit të ekspertimit kanë rezultuar se janë një (1) plumb (predhë) e dëmtuar pjesë e fishekut të kalibrit 9x19mm dhe një (1) gëzhjë e pjesë e fishekut të kalibrit 9x19mm që janë gjuajtur nga një armë e kalibrit të njëjtë 9x19mm;

Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

### III

Konform nenit 362 par. 1, nënpar.1.1 të KPPRK-së.

### REFUZOHET AKTAKUZA

Sepse:

Më datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e parë dhe të dytë, të pandehurit A.B.1 dhe A.B.2, me dashje eventuale dhe në mënyrë të kundërligjshme, i ka dëmtuar shtëpinë e banimit të dëmtuarit në atë mënyrë që, si pasojë e të shtënave me armë zjarri të përshkruara si në dispozitivin e parë, i pandehuri ka dëmtuar xhamin e dritares, roletën si dhe murin e dhomës së gjumit që gjendet në katin e parë, ana e pasme e shtëpisë së të dëmtuarit, me ç'rast si pasojë të dëmtuarit i shkakton dëm material në vlerë rreth njëmijepesëqind (1500) euro;

Me këtë kishin për të kryer veprën penale në bashkëkryerje Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 321 par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sepse prokurori i shtetit ka heqë dorë nga ndjekja penale në marrëveshjen për pranimin e fajësisë PP/I.nr.74/2024 të datës 18.10.2024 dhe në seancën dëgjimore të datës 04.11.2024.

Andaj, gjykata konform neneve 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 79 dhe 80 të KPRK-së, si dhe neneve 230, 364 dhe 449 të KPPRK-së, të pandehurit i:

## G J Y K O N

I. Të akuzuarin A.B.1 për veprën penale si në piken I të këtij aktgjykimi, i shqipton DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Dhe për veprën penale nga pika II e këtij aktgjykimi, i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej 2,500 (dymijepesëqind) euro të cilin dënim me gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par.3, të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

II. Të akuzuarin A.B.2, për veprën penale nga pika I e këtij aktgjykimi i shqipton DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 79 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar me burgim të akuzuarve i llogaritet koha e kaluar në paraburgim, të akuzuarit A.B.1 nga data 16.04.2024 e tutje dhe të akuzuarit A.B.2 nga data 04.06.2024 e tutje.

Obligohen të akuzuarit që të paguajnë shpenzimet e procedurës dhe atë për paushallin gjyqësor, secili veç e veç shumën prej njëqindë (100) €, në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari A.O nga Prishtina, me vendbanim në rr. "...", në seancën dëgjimore të datës 14.11.2024, ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

I dëmtuari Enver Derguti nga Prishtina, me vendbanim në rr. "...", lagja ..., në Çagllavicë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, në këtë gjykatë, ka paraqitur aktakuzë nën shenjën PP/I.Nr.74/2024, të datës 24.06.2024, ndaj të pandehurve: A.B.1 dhe A.B.2 për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Vrasje në tentative nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe me nenin 31 dhe veprës penale në bashkëkryerje Asgjësimit apo dëmtim i pasurisë, nga neni 321 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i pandehuri A.B.1 edhe për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me datën 16.09.2024 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ku pas leximit të aktakuzës, të akuzuarit janë deklaruar të pa fajshëm, me ç'rast gjykata të pandehurit dhe mbrojtësin e tyre i ka udhëzuar që brenda afatit prej 30 ditësh të paraqesin çdo kundërshtim të provave dhe çdo kërkesë për hedhje të aktakuzës.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 04.11.2024, ndërsa me datë 23.10.2024 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë PP/I.nr.74/2024 të datës 18.10.2024, në bazë të së cilës është mbajtur seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjatë së cilës seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit, të akuzuari dhe mbrojtësit e tyre si dhe i dëmtuari A.O me përfaqësuesin e tij av. Jeton Maqedonci, në të cilën seancë të pandehurit A.B.1 dhe A.B.2 kanë deklaruar se e pranojnë fajësinë dhe qëndrojnë pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të arritur në prokurori për veprat penale që i vihen në barrë sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit.

Prokurorja e shtetit Fatmire Cacaj ka deklaruar se: në kuadër të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë kemi paraparë edhe dënimin e rekomanduar për të pandehurit, ashtu që dënimi i rekomanduar në bazë të marrëveshjes së pranimit të fajësisë është si në vijim: sa i përket të pandehurit A.B.1 për veprën nga pika I e dispozitivit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej (1) një viti e tetë muaj deri dy vjet burgim, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim, për veprën nga pika II e dispozitivit, dënim me gjobë prej dymijë e pesëqindën (2.500) euro deri në tremijë e pesëqind (3.500) euro. Sa i përket të pandehurit A.B.2 për veprën nga pika I e dispozitivit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej (1) një viti e një muaj deri në një (1) vit e pesë muaj burgim, në të cilin do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B.1, av. Ramiz Krasniqi, ka deklaruar se rekomandimi i bërë në marrëveshje nuk e obligon këtë gjykatë dhe duke pas parasysh rrethanat lehtësuese të të mbrojturit tim siç është mungesa e pasojës tek vepra penale e që zakonisht pasoja është ajo që e rendon pozitën e të akuzuarit, faktin se i mbrojturi im është pajtuar me të dëmtuarin, tutje si rrethanë lehtësuese thekson se i mbrojturi i tij vullnetarisht është paraqitur në polici dhe se për fatin e keq është kapluar nga një sëmundje e rende, në bazë të këtyre kërkojmë që dënimi të jetë më i butë se sa minimumi i theksuar në marrëveshje.

I akuzuari A.B.1 ka deklaruar se pajtohet me dënimin e rekomanduar në marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe nuk kam çfarë të shtoj me shumë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B.2, av. Saranda Keqekolla Sadiku ka deklaruar se sa i përket sanksionet penal lidhur me të mbrojturin tim e lus gjykatën që të këtë parasysh dënimin e rekomanduar në marrëveshjes, të njëjtit të i shqiptohet një sanksion më i butë penal kjo për shkak të asaj se nuk ka pasojë nga vepra penale, tutje thekson se palët janë pajtuar dhe se i mbrojturi i saj asnjëherë më parë nuk ka qene në burg dhe duke e pas parasysh faktin se marrëveshja është bërë qysh në fazën fillestare gjykata të shqiptoj një dënim më të ulët.

I akuzuari A.B.2 ka deklaruar se pajtohet me dënimin e rekomanduar në marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe nuk kam çfarë të shtoj më shumë.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar A.O av. Jeton Maqedonci deklaron se nuk e kundërshtojmë marrëveshjen sa i përket lartësisë së dënimit.

I dëmtuari A.O deklaron se nuk e kundërshtojmë marrëveshjen dhe e mbështes fjalën e përfaqësuesit tim po ashtu thekson se nuk kërkojmë kompensim të dëmit ndërsa e ndjejmë veten si palë të dëmtuar.

Gjykata ka aprovuar marrëveshjen për pranim të fajësisë nën shenjë PP/I.nr.74/2024 të datës 18.10.2024 për të pandehurit A.B.1 dhe A.B.2, pasi që e njëjta është përpiluar konform nenit 230 të KPPRK-së, në marrëveshje është paraparë edhe dënimi ku palët janë dakorduar që sa i përket të pandehurit A.B.1 për veprën nga pika I e dispozitivit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej (1) një viti e tetë muaj deri dy vjet burgim, në të cilin dënim do të llogarite koha e kaluar në paraburgim, për veprën nga pika II e dispozitivit, dënim me gjobë prej dymijë e pesëqindë

(2.500) euro deri në tremijë e pesëqind (3.500) euro. Sa i përket të pandehurit A.B.2 për veprën nga pika I e dispozitivit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej (1) një viti e një muaj deri në një (1) vit e pesë muaj burgim, në të cilin do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim.

Pas deklarimit të akuzuarve, mbrojtëseve, prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit lidhur me marrëveshjen për pranimit të fajësisë, për veprat penale si në hyrje të këtij dispozitivi, gjykata u bind se të akuzuarit i kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, të pranuar nga i akuzuari, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike prandaj, gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase janë përmbushur kushtet për pranimitin e fajësisë bazuar në dispozitat ligjore të KPPRK-së.

Pas pranimit të fajësisë dhe konstatimit të përmbushjes se kushteve të parapara në nenin 242 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në nxjerrjen dhe administrimin e provave të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale që u vihet në barrë, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nisur nga pranimi i fajësisë, Gjukata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje Vrasje në tentative nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale nga i pandehuri A.B.1 Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së. Andaj, gjykata të njëjtit i shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht janë përgjegjës dhe e gjykoi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjukata të akuzuarve u shqiptoj dënim më të lartë se sa dënimi i rekomanduar në marrëveshjen e pranimit të fajësisë duke u mbështetur në nenin 230 par.12 të KPPRK-së, pasi që gjykata nuk është e lidhur me dënimin e propozuar nga ana e palëve, e duke u mbështete në nenin 72 të KPRK-së, të kufijtë e zbutjes së dënimeve, e për veprën penale në bashkëkryerje Vrasje në tentative nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe me nenin 31 të KPRK-së, si masë më e butë e dënimit, parashihet burgim së paku 5 vite dhe dënimi mund të zbutet konform nenit 72 par.1, pika 1.2 të KPRK-së, deri në tri vite burgim, e cila dispozitë është inkorporua në nenin 230 par.1, pika 1.1 të KPPRK-së ku thuhet se *“Në çdo kohë para ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruar për pranimitin e fajësisë, në*

*bazë të së cilës i pandehuri dhe prokurori i shtetit pajtohen për akuzat e përfshira në aktakuzë dhe i pandehuri pajtohet të pranojë fajësinë në shkëmbim për: pajtimin e prokurorit të shtetit që t'i rekomandojë gjykatës dënim më të butë. Kjo mund të përfshijë rekomandimin për një dënim nën minimumin e dënimit të paraparë me ligj, por jo nën kufijtë e zbutjes së dënimit” e në rastin konkretë marrëveshja është arritur nën kufijtë e zbutjes së dënimit, e për gjykatën një zbutje e tillë nuk është e mbështetur në dispozitat ligjore të lartcekura.*

Ndërsa sipas par.15 të nenit 230 të KPPRK-së, thuhet se *“Gjykata zyrtarisht mund të pranoj apo refuzoj marrëveshjen për pranimin e fajësisë në pajtim me kushtet që duhet të merren parasysh nga par.17 i këtij neni”*. E që gjykata ka vlerësuar se të gjitha kushtet janë plotësuar nga paragrafi 17 i këtij neni dhe atë pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, të pandehurit, mbrojtësit së tij dhe të dëmtuarit, gjykata ka vlerësuar se nuk ka bazë ligjore të refuzimit të marrëveshjes, pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet e nenit të lartcekur, andaj vetëm sa i përket rrethanat mbi dënimin gjykata vlerëson se nuk është e mundur të refuzohet marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, mirëpo palët sa i përketë kësaj pike mund të ushtroj ankesë e cila e paraparë me nenin 230 par.12 të KPRK-së.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarit, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, andaj si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të akuzuarit mori faktin se, të njëjtit kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë në prokurori dhe ka mbetur pranë saj edhe në gjykatë, pendimin e thellë dhe shprehjen e keqardhjes para gjykatës për kryerjen e këtyre veprave, po ashtu si rrethanë për të pandehurin A.B.1 si rrethanë lehtësuese mori gjendjen e tij jo të mirë shëndetësore (i diagnostikuar me kancer të lëkurës), ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori faktin se i pandehurit A.B.1 është recidivist pasi që sipas evidencës penale i njëjti me parë ka qenë i dënuar sipas aktgjykimit P.nr.70/2022 me dënim 600 euro gjobë, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 16.01.2023, aktgjykimit P.nr.38/2024 me dënim 12 muaj burgim, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 17.07.2024, me aktgjykimin P.nr.426/2024 me dënim me 4 muaj burgim, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 20.08.2024, me aktgjykimin P.nr.194/2023 me dënim me 6 muaj burgim me kusht për 2 vite dhe 250 euro gjobë, i cili është bërë i plotfuqishëm me 12.07.2024. Po ashtu për të pandehurin A.B.2 si rrethanë rënduese vlerësoj faktin se i pandehurit A.B.2 është recidivist pasi që sipas evidencës penale i njëjti me parë ka qenë i dënuar sipas aktgjykimit P.nr.2451/2021 me dënim 250 euro gjobë, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 08.11.2023, tutje si rrethanë rënduese ndaj të akuzuarve gjykata gjeti mënyrën si e kanë kryer veprën penale dhe shkallën e lartë të dashjes. Andaj gjykata duke i pasur



parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura dhe dispozitave nga neni 71 dhe 72 të KPRK-së, i shqiptoj dënim nën kufirin e paraparë me ligj dhe sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit komfor nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata vendosi si në pikën III të këtij aktgjykimi pasi që prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza në marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe në seancën dëgjimore duke theksuar se në konsultim me kryeprokurorin dhe në respektim të nenin 230 par.2 pika 2.2 të KPPRK-së, tërhiqemi nga ndjekja penale sa i përket pikës III për të pandehurin A.B.1 dhe A.B.2 për veprën penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë, nga neni 321, par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, prandaj, gjykata refuzoi aktakuzën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë konform nenit 449, par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 39, par.3, pika.3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 05/L036).

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 230, 362 dhe 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.124/24, datë 20.11.2024

G j y q t a r i

---

Numri i lëndës: 2024:178270  
Datë: 20.11.2024  
Numri i dokumentit: 06482682

Alban Ajvazi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.